



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 248/1 prot.

Lënda: Konfirmim akti

Elbasan, më 16.2 2026

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr.24 dt. 12.02.2026 “Për shpalljen e zonave prioritare të zhvillimit në Bashkinë Librazhd”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA



247
13.2.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 903 prot

VENDIM

Datë.13.02.2026

Nr.24 dt.12.02.2026

**"PËR SHPALLJEN E ZONAVE PRIORITARE TË ZHVILLIMIT NË BASHKINË
LIBRAZHD"**

Këshilli i Bashkisë Librazhd, bazuar në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, Ligjin nr.20/2025 "Për paketën e maleve", Udhëzimin nr.1, datë 19.06.2025 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e bashkive" Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me date 12.02.2026 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI:

1. Të miratojë shpalljen e disa zonave zhvillimore në Njësitë Administrative **Qendër, Stëbleve, Hotolisht, Polis, Orenjë dhe Lunik** si zona prioritare të zhvillimit në territorin e **Bashkisë Librazhd;**
2. Të miratojë **dokumentacionin** shoqërues si më poshtë:
 - a. Projektaktin e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të punës;
 - b. Relacionin shoqërues, hartuar në përputhje me parashikimet e pikës 4, të këtij udhëzimi, që evidenton përmbushjen e të gjitha detyrave të grupit të punës.
 - c. Hartën e zonës së propozuar, sipas sistemit KRGJSH, të paraqitur mbi ortofoto (manual dhe digjital);
 - d. Hartën e zonës së propozuar, të pasuruar me informacionin kadastral (manual dhe digjital);
 - e. Hartën e zonës së propozuar, të pasuruar me informacionin e Planit të Përgjithshëm Vendor (manual dhe digjital);
 - f. Listën e aktiviteteve të mundshme/të synuara për zhvillim, bazuar në analizën e sektorëve me prioritet;
 - g. Dokumentacion që provon realizimin e konsultimeve paraprake me komunitetin lokal dhe palët e interesuara;

- h. Të dhëna mbi praninë e poseduesve jopronarë brenda zonës së propozuar, statusin ligjor dhe kategorinë (klasifikimin) e pronës;*
- i. Raport mbi infrastrukturën ekzistuese dhe nevojat për investime infrastrukturore.*
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, grupi i punës dhe administrata e Bashkisë Librazhd.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55, pika 6 .

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA



ZV/KRYETARE E KËSHILLIT
Silvana HOXHA

